

VENDIM
Nr. 107, datë 6.3.2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, GJYKATËN E LARTË, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1/2:

i) shtohen emërtesat "Qendra e Botimeve për Diasporën" dhe "Avokatura e Shtetit";

ii) emërtesa "Komiteti Shtetëror i Minoriteteve" zëvendësohet me "Komiteti për Pakicat Kombëtare".

b) Në shkronjën "a", të pikës 1/3, emërtesat "Avokatura e Shtetit" dhe "Sekretariati Kombëtar i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI - Shqipëri)", shfuqizohen;

c) Në shkronjën "b", të pikës 1/3:

i) emërtesa "Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit" zëvendësohet me "Agjencia Kombëtare e Falimentimit";

ii) emërtesa "Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike" zëvendësohet me "Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas";

iii) shtohet emërtesa "Sekretariati Kombëtar i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI - Shqipëri)";

iv) emërtesa "Shtëpia Botuese e Librit Universitar" shfuqizohet.

ç) Në shkronjën "c", të pikës 1/3:

i) emërtesat "Qendra e Realizimit të Veprave të Artit" dhe "Klubi Shumësportësh Partizani" shfuqizohen;

ii) shtohet emërtesa "Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit".

d) Në lidhjen nr. 2, që përmendet në pikën 2/"a", në rreshtin e parë të kolonës së dytë, pas emërimit "Master i Arteve" shtohet "Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike".

dh) Në lidhjen 3, që përmendet në pikën 3, shtohet, si më poshtë vijon:

Komisioneri i Mbrojtjes nga Diskriminimi	Inspektor	III-a
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Koordinator në Sekretariat (Drejtorinë e Përgjithshme) e BE-së	III-a

e) Pika 4/14 shfuqizohet.

ë) Në pikën 6:

i) pas paragrafit "Zëvendësministër" shtohet paragrafi "- Kryetar i Komitetit për Pakicat Kombëtare - 153 300 lekë";

ii) paragrafët e Prefektit të Qarkut Tiranë, prefektëve të qarqeve të tjera dhe nënprefektëve ndryshohen, si më poshtë vijon:

“- Prefekt 153 300 lekë;
- Nënprefekt 123 000 lekë.”.

f) Pas pikës 8/9 shtohet pika 8/10, me këtë përmbajtje:

“8/10. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës në administratën e Avokaturës së Shtetit janë sipas lidhjes nr. 5/10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Nëpunësit e Avokaturës së Shtetit, të cilët deri në datën 10.2.2012 përfitonin një pagë më të lartë sesa parashikohet në lidhjen nr. 5/10, do të vazhdojnë të përfitojnë pagën e mëparshme. Nëpunësit e tjerë përfitojnë pagat sipas përcaktimit në lidhjen nr. 5/10.

Nëpunësi i emëruar jashtë vendit, në pozicionin “Jurist pranë Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Evropës, i cili është përfaqësues i përhershëm pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, ka statusin financiar të përfaqësuesit të ministrisë së linjës në përfaqësinë tonë diplomatike pranë BE-së.”.

g) Paragrafi i dytë i pikës 9 shfuqizohet.

gj) Në lidhjen nr. 6/6, që përmendet në pikën 9/6, pas emërtesës “Inspektor audit” shtohen emërtesat “Këshilltar në kabinetin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve” dhe “Shef zyre në zyrën e zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve”.

h) Pika 9/9 dhe lidhja 6/9 shfuqizohen.

i) Në pikën 10 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Nëpunësit e Sekretariatit Kombëtar të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI - Shqipëri), të cilët sipas organizimit të mëparshëm kanë pasur emërtesën “koordinator” dhe një nivel page më të lartë se përcaktimi i këtij vendimi, do të vazhdojnë të përfitojnë pagën që kanë pasur sipas organizimit të mëparshëm.”.

j) Pas pikës 14 shtohet pika 14/1, me këtë përmbajtje:

“14/1. Punonjësit në projektet me tituj “Projekte me KfW”, “Projekti i kanalizimeve të Tiranës së Madhe”, “Projekti i shërbimeve esenciale”, në Agjencinë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, deri në përfundimin e projektit përkatës të trajtohen me pagë:

- drejtues projekti (koordinator) - kategoria II-a;
- specialist - kategoria III-b.

Punonjësit në projektet e programeve IPA në Agjencinë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, deri në fund të vitit 2019, të trajtohen me pagë, si më poshtë vijon:

- drejtues projekti (koordinator) - kategoria II-a;
- specialistët - kategoria III-b.

Për vitin 2020 e në vijim, punonjësit e projekteve të programeve IPA në Agjencinë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve të trajtohen me pagë njësoj si nëpunësit e tjerë të kësaj agjencie.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2019, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion dhe;

- a) për prefektët dhe nënprefektët, të fillojnë nga data 1 janar 2019;
- b) për përcaktimin në shkronjën “d” të fillojnë nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi;
- c) për të gjitha parashikimet e tjera të fillojnë nga momenti i transferimit apo emërimit të nëpunësve në pozicionet e reja, pas miratimit të strukturave dhe organikave përkatëse.

3. Pika 19/1, e vendimit nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës në administratën e Avokaturës së Shtetit

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Jurist	III-b	1 ose 2
Specialist	IV-a	1, ose 2, ose 3
Sekretar	IV-b	1, ose 2, ose 3

